

NJOFTIM

**Organizimi i dëgjësës me grupet e interesit dhe publikun për konsultimin e
RAPORTIT TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR**

Për

**STRATEGJINË KOMBËTARE TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE, 2023-2030**

Datë: 11.04.2023

Ora: 10:30

Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

RELACION

QËLLIMI I HARTIMIT TË STRATEGJISË:

Qëllimi i Strategjisë së Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është të përmirësojë ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për qytetarët e Shqipërisë dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit, bazuar në kryerjen e një shërbimi kryesor të infrastrukturës. Për të realizuar përmbushjen e këtij qëllimi, është thelbësore që Strategjia të përcaktojë disa të dhëna bazë dhe informacion që kanë të bëjnë me popullsinë, modelet e saj të ndryshimit dhe gjendjen ekonomike të popullsisë.

Qeveria e Shqipërisë ka prioritet parësor sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime të besueshme të menaxhuara në mënyrë eficiente dhe të sigurt dhe planifikon mbështetjen e nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm kombëtar; rritjen e standardeve të jetesës dhe mirëqenien e popullsisë dhe përmirësimin e konsiderueshëm të shëndetit. Reformat e qeverisë janë hartuar për të sjellë përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime.

Kjo Strategji Sektoriale për Shërbimet Ujësjellës Kanalizime për periudhën 2023-2030 është përgatitur me qëllim për të paraqitur Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjike dhe Planet e Veprimit në Shqipëri në mënyrë të qartë, specifike, sasiore dhe kohore, në përputhje me Angazhimet e Vendit tonë drejt arritjes së Objektiveve për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Kjo Strategji e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime do të shqyrtohet nga

Këshilli i Ministrave për të bashkërenduar objektivat dhe prioritetet kryesore të sektorit UK në Republikën e Shqipërisë, si dhe hartimin e propozimeve për zbatimin dhe financimin e politikave me qëllim arritjen e këtyre objektivave brenda periudhes 7 vjeçare të Strategjisë. Strategjia ndërthur gjetjet nga Konsultimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës dhe analizat përkatëse, duke përfshirë një vlerësim të detajuar të situatës aktuale, kuadrin ligjor dhe rregullator, shpenzimet publike të planifikuara dhe burimet e financimit për sektorin e ujit.

Si një vend bashkë-sponsorizuese e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara për “Aksesin me Ujë të Pijshëm të sigurtë dhe Kanalizime si e drejtë e njeriut” është e angazhuar të bëjë atë cka i takon për të garantuar barazi për të gjithë qytetarët përsa i përket të drejtave të njeriut në lidhje me ujin e pijshëm dhe kanalizimet. Ekziston një objektiv specifik për ujin dhe kanalizimet, i cili shkon përtej ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime drejt menaxhimit të ujërave të ndotura, cilësisë së ujit në mjedis, efikasitetit të ujit, menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe mbrojtjes së ekosistemeve ujore si tregues të rëndësishëm.

Qeveria e Shqipërisë është e vetëdijshme që është përgjegjëse për mbrojtjen e burimeve natyrore të vendit si një pasuri e madhe kombëtare. Duke patur parasysh këtë fakt, kjo Strategji synon të japë kontributin e saj në mbrojtjen dhe administrimin e këtyre burime natyrore jo vetëm sot, por për të gjithë brezat që vijnë. Për këtë arsye, kjo strategji është një hap i madh dhe realizimi i saj do të përmbushë premtimin për të ofruar ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime për të gjithë në të ardhmen.

Vizioni

Deklarata e Vizionit është një mesazh i thjeshtë por i fuqishëm që përshkruan punën e madhe për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime si shërbime thelbësore dhe kritike për jetën e njeriut. Deklarata e kësaj Strategjie Sektoriale përcakton drejtimin ku do të fokusohen investimet duke synuar cilësinë më të lartë të shërbimeve për periudhën 2023-2030.

VIZIONI

UJË PËR NJERËZIT, NJERËZIT PËR UJIN

Drejt një sektori të mirë organizuar të furnizimit me ujë dhe kanalizime që siguron shërbime cilësore në mbrojtje të shëndetit publik dhe kontribon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Misioni i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime

Bazuar në aspiratat e qeverisë shqiptare për zbatimin e direktivave të BE-së, Deklarata e Misionit pasqyron qëllimin themelor të kësaj Strategjie.

Deklarata e Misionit për këtë Strategji Sektoriale shërben për të përqendruar nismat e Qeverisë në gjashtë objektivat strategjike kyçe që duhet të adresohen, si në politika ashtu edhe në veprime, për të arritur përmirësimin e dëshiruar në shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

DEKLARATA E MISIONIT

Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Europian dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Parimet Kryesore të Strategjisë së Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime

Strategjia e Sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime mund të përcaktojë kushtet që duhen plotësuar si dhe mund të shërbejë si bazë për arritjen e Parimeve Kryesore të sektorit.

PARIMET KRYESORE TË STRATEGJISË SË SEKTORIT

QËNDRUESHMËRI	Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime duhet të jenë ekologjikisht, teknikisht dhe financiarisht të qëndrueshëm përmes mbulimit të plotë të kostos.
PËRPUTHSHMËRI	Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizime ofron qasje universale që i plotëson të gjitha kërkesat rregullatore / europiane sipas parimit ndotësi paguan.
EFIÇIENCË	Shoqëritë e furnizimit me ujë dhe kanalizime të kenë efikasitet dhe performancë të cilësisë së shërbimit të barabartë me praktikën e mirë evropiane dhe sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese
PËRBALLUESHMËRI	Të sigurohet ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët me një çmim të përballueshëm.
TRANSPARENCË	Të sigurohet pjesëmarrja e publikut dhe transparenca në politikat e ujit.

Politikat dhe Objektivat Strategjik në Mbështetje të Masave Prioritare për Sektorin

Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është një dokument i rëndësishëm që do të orientojë Qeverinë në përpjekjet e saj në përmirësimin e sektorit UK. Strategjia parashikon (6) gjashtë objektiva strategjike të cilat janë specifike, të matshme dhe me afate kohore.

Më tej, këto gjashtë Objektiva Strategjike janë përkthyer në Rezultate/Masa Prioritare të cilat do të detajohen nëpërmjet Planeve të Veprimit. Secila Masë Prioritare është shoqëruar me një objektivi të caktuar të performances, që do të monitorohet gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kësaj Strategjie.

Për të vendosur një referencë, si vit bazë është marrë 2021. Duke përdorur vlerat vjetore të vitit bazë për Treguesit e Performancës, Grupi i Punës Ndërinstitucional, i cili ishte përgjegjës për zhvillimin e Strategjisë Sektoriale, përcaktoi një vlerë të arritshme për Treguesin e Performancës për vitin e fundit të periudhës së planifikimit, 2023-2030, si dhe vlerat e ndërmjetme për secilin nga 7 vitet e periudhës së planifikimit.

Këto tregues të parashikuara për secilën masë prioritare janë elementë kryesorë për të monitoruar, vlerësuar dhe raportuar progresin në zbatimin Strategjisë në termat kohore (2023-2025), dhe (2026-2030). Ato gjithashtu do të përdoren për të identifikuar çdo devijim në mes të performancës së parashikuar dhe arritjeve aktuale vjetore në terren dhe si rrjedhim të përcaktojnë veprimet korrigjuese dhe të përditësojnë Strategjinë kur është e nevojshme.

Planet e Veprimit në mbështetje të Masave Prioritare

Ky kapitull i Strategjisë Sektoriale paraqet Planet e Veprimit për zbatimin e Masave Prioritare të identifikuar si kusht për arritjen e Objektivave Strategjike. Çështjet e mëposhtme adresohen si mëposhtë:

- Çfarë kërkohet për zbatimin e masës prioritare?
- Kush është përgjegjës për zbatimin e masës prioritare?
- Kur duhet (dhe mund) të zbatohet masa prioritare?
- Sa do të kushtojë zbatimi i masës prioritare?
- Sa do mbulohen nga PBA e rradhës?
- Sa është hendeuku financiar?

Monitorimi dhe Përditësimi i Strategjisë

Ky kapitull i strategjisë paraqet disa udhëzime për mënyrën se si do të zbatohet, monitorohet dhe përditësohet Strategjia aktuale gjatë zbatimit të saj.

VLERESIMI STRATEGJIK MJEDISOR

Qëllimi i punës është zbatimi i kërkesave që rrjedhin nga ligji nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor” dhe të gjitha akteve nënligjore që rrjedhin prej tij dhe ndjekja e procedurave të VSM-së.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces sistematik që vlerëson pasojat në mjedis të një dokumenti strategjik planifikues të propozuar për zbatim me qëllim që të sigurojë që këto pasoja mjedisore të adresohen plotësisht që në fazat e hershme të vendimmarrjes përkrah konsideratave ekonomike dhe sociale.

VSM-ja duhet të paraqesë informacione mbi ato ndikime mjedisore, ekzistenca dhe pasoja e të cilave nuk janë të përcaktuara me saktësi. Në këtë mënyrë VSM-ja në gjatë hartimit të dokumentave strategjik planifikues mund të kontribuojë për një përmirësim të procesit të planifikimit dhe vendimmarrjes, meqë është një vlerësim gjithëpërfshirës, sistematik dhe transparent i aspekteve mjedisore, sociale dhe ekonomike si dhe i implikimeve problematike të planifikimit. Konfliktet e ardhshme midis mbrojtjes së mjedisit dhe kërkesave të interesave sektorialë në planifikim (kryesisht në planifikimin e përdorimit të tokës) nuk mund të zgjidhen gjatë procesit të VSM-së. Këto kërkojnë zgjidhje politike, të bazuara në informacion dhe vlerësime të besueshme, që mund të transformohen në vendime për një alternativë të caktuar planifikimi.

Detyra e VSM-së është kontributi në një vendim të tillë me transparencën dhe detajet e tij të hollësishme. Në një shoqëri demokratike është tepër e vështirë të neglizhosh apo të mos pranosh informacione mbi ndikime të parashikuara në mjedis dhe në shëndet, të zhvillimeve që mblidhen dhe dokumentohen në mënyrë sistematike, si dhe vlerësohen në mënyrë objektive.

Detyra e VSM është të kontribuojë për një planifikim strategjik të tillë që nga pikëpamja e mjedisit dhe e shëndetit publik është jo vetëm i tolerueshëm por edhe optimal, ndërkohë që edhe kërkon për alternativa të ndryshme duke marrë në konsideratë efektet mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Është e nevojshme të theksohet vlera e shtuar e VSM-së në planifikim si një lehtësues për vendimmarrje të qëndrueshme. Është më se i njohur fakti se planifikimi hapësinor dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor janë kushte paraprake për të arritur forma të pranueshme zhvillimi.

Sipas ligjit 91/2013 mbi VSM, procesi i vlerësimit strategjik mjedisor kalon detyrimisht në këto faza të njëpasnjëshme:

1. Njoftimi i Ministrisë nga autoriteti propozues;
2. Konsultimi me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së;
3. Hartimi i raportit paraprak dhe konsultimi me grupet e interesit dhe publikun në lidhje me të;
4. Hartimi i raportit përfundimtar të Vlerësimit Strategjik Mjedisor;
5. Shqyrtimi i propozimit dhe deklarata e ministrit;
6. Vendimi i autoritetit miratues;
7. Monitorimi dhe raportimi i pasojave në mjedis të planit apo programit.

Ecuria e hartimit të VSM-se perkatëse do të realizohet përmes disa hapave dhe analizave. Keta hapa dhe analiza do të detajojnë përmbajtjen e fazave të VSM-se, të përmendura më sipër, dhe do të përbejnë dokumentacionin perkatës që përgatitet dhe dorëzohet për çdo fazë. Hapat/analizat janë:

- Shqyrtimi
- Studimi i shtrirjes/qellimit të VSM
- Analiza e gjendjes ekzistuese
- Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse (përfshirë monitorimin)

➤ Hartimi i raportit të VSM-se

Aktivitetet që lidhen me konsultimin me grupet e interesit do të realizohen në disa faza përgjate këtyre hapave analitike, (sic parashikohet në ligj). Konkretisht, përpara hartimit të raportit shqyrtues është kryer takimi konsultativ me grupet e interesit mbi prezantimin e Planit.

Në metodologjinë e propozuar është dhënë përafrimi ndaj VSM-se dhe janë mbajtur parasysh të gjithë hapat dhe aktivitetet e parashikuara. Për më tepër, në ndjekjen e hapave dhe realizimin e aktivitetëve (nisur që prej hapit të parë „Shqyrtimi“) janë specifikuar çështje të ndryshme që lidhen me ndikimin e planit përkatës në sektoret dhe elementet e ndryshëm të mjedisit, sic janë:

- ✓ ndikimet në zonat e mbrojtura,
- ✓ ndikimet në brezin e bregdetit,
- ✓ ndikimet në cilësinë e ujit dhe ekosistemet detare dhe tokësore,
- ✓ ndikimet në zonat e gjelbra dhe hapësirat publike në zonat e banuara,
- ✓ ndikimet në administrimin e mbetjeve,
- ✓ ndikimet tek peisazhi,
- ✓ ndikimet në zhvillimin e qendrueshëm të turizmit,
- ✓ ndikimet sociale mbi komunitetin(et) respektive etj.

Me poshtë jepet në mënyrë të përmbledhur Plani i Punës për realizimin e Raportit të VSM-së për Strategjinë për Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve.

Nr	Hapi/Procesi i punës	Përgjegjësi
1	Konsultime me palët e interesuara për çështje që duhet të adresohen në raportin e VSM-së (organizimi i dëgjimit publik)	Konsulenti mjedisor MIE/AKUM
2	Hartimi i një raporti paraprak të VSM-së dhe konsultimi me palët e interesuara dhe publikun për këtë raport;	Konsulenti mjedisor në bashkëpunim me MIE/AKUM
3	Konsultime me palët e interesuara dhe publikun për raportin paraprak të VSM-së (organizimi i dëgjimit publik);	Konsulenti mjedisor MIE/AKUM MTM
4	Hartimi i draft raportit të VSM	Konsulenti
5	Hartimi i draftit final të raportit për konsultime me aktorët/grupet e interesit	MIE/AKUM Konsulenti

6	Aplikimi për Deklaratën e Mjedisit. MIE i dërgon MTE kërkesën së bashku me raportin e VSM-së dhe Strategjinë përfundimtare	MIE/AKUM në bashkëpunim me Konsulentin mjedisor
7	MTM lëshon deklaratën mjedisore	MTM